

Albanisch:

Shpjegim

PËR TË DREJTAT E TË LËNDUARVE DHE DËMTUARA NË NJË PROCEDURË PENALE

I. Të drejtat që ju takojnë të gjithë personave të lënduar/të dëmtuar me rastin e një vepre penale

1. A është e mundur je kam mbështetje në një procedurë?

Ju mund te keni përkrahje nga një organizatë për mbështetjen e viktimave. Adresat e organeve të tilla mund të merren nga zyrat gjyqësore për parashtrimin e kërkesave sie dhe mund t'ju drejtoheni me këtë pyetje edhe organeve policore.

Ju gjithë ashtu mund të autorizoni një avokat¹ i cili Juve ju prezanton në procedurë. Ky në këtë rast ka të drejtë ti shikoj dosjet, te jetë prezent kur Ju merreni në pyetje. Shpenzimet e avokatit zakonisht duhet te paguhen nga Ju. Por në raste te jashtëzakonshme për Ju mund te autorizohet një avokat, të cilin Ju nuk e paguani, dhe atë në raste kur fjala është për vepra të rënda penale.

Kur Juve merrni në pyetje mund te sillni persona te besueshëm nga Ju të cilët parimisht mund të jenë prezent.

2. A është e mundur, qe të dhënat e mia personale të mbahen sekret?

Ju parimisht është e domosdoshme, qe kur te merrni në pyetje, ti jepni të dhënat tuaja personale (duke përfshirë mbiemrin, emrin, statusin martesor dhe vendbanimin). Por në raste të një kërcënimi të rrezikut të posaçëm, mund te vije deri te ajo, qe në tërësi ose pjesërisht, të mbrohen të dhënat e Juaja.

3. A mund ta di, se çfarë ndodh në këtë proces?

Ju mund të bëni kërkesën pran prokurorisë apo gjykatës qe te njoftoheni mbi rezultatin e procedurës. Në veçanti, Ju mund të kërkoni për të mësuar, se personit të dënuar a ju ka dhënë udhëzime që ti përmbahet çdo kontakti me Juve

Ju mund të kërkoni te njoftoheni për faktin, se a është i akuzuari ose i dënuar ende në burg ose a i janë dhënë atij lehtësime nga burgu ose i është miratuar një pushim.

Kërkesa duhet ta bëni duke e dhënë një arsye legjitime të bazuar në interesat e Juaj.

Ju gjithashtu mund të kërkonti informacione dhe kopje nga dosjet. Gjithashtu edhe këtë kërkesë Ju duhet bërë duke e arsyetuar një interes të ligjshëm. Por shikimi në dosje mund tu lejohet vetëm avokatëve.

Ju leni të lutur të jepni në të gjitha kërkesat tuaja - sa herë që të jetë e mundur - emrat dhe mbiemrat e plotë të pandehurve si dhe numrin e dosjes së prokurorisë ose të gjykatës apo numri operativ të policisë.

4. A mund të kërkoj kompensim të dëmit në procedurat penale?

Si i lënduar apo trashëgimtari i tij mund të bëni kërkesën për kompensim në pronë në një procedurë penale kundër të akuzuarit, (p.sh. një kërkesë për kompensim ose dëmshpërblim ose të kërkonti të paguheni për shkaktim të dhimbjeve) nëse i pandehuri në kohë të veprës ishte të paktën 18 vjet.

Ju mund të bëni një kërkesë të tillë me shkrim pran gjykatës, ose për Ju të lëni atë të shkruaj dikush nga gjykata, ose në procedurën kryesore gjyqësore të diktoni në gjyq me gojë. Në këtë kërkesë, ju duhet të deklaroni, që çka Ju kërkonti nga i pandehuri dhe pse. Përveç kësaj, kërkesa juaj duhet të përmbajë dëshmitë e duhura.

II. Të drejtat shtesë në raste të caktuara.

1. Cilat raste janë këto?

Të drejtat shtesë që Juve ju takojnë, nëse Juve jeni lënduar një nga veprat penale të shënuara më poshtë janë:

- Vepër penale kundër vetëvendosje seksuale (p.sh. përdhunim, abuzim seksual)
- Vepër penale kundër jetës apo integritetit fizik të shëndetit (p.sh. tentativë vrasje, plagosje e qëllimshme)
- Vepër penale kundër lirisë personale (p.sh. trafikim i qenieve njerëzore, forma të rënda të privimi nga liria)
- Shkelja e një urdhri nga gjykata që ka të bëjë me mbrojtjen kundër dhunës
- Tranzalim (stalking)

Drejta të njëjta ju takojnë Juve, nëse Ju jeni të plagosur me rastin e një vepre tjetër penale në rrethana të veçanta, nëse Ju keni vuajtur pasoja serioze nga vepra penale.

Këto të drejta Juve ju takojnë nëse një i afërm i Juaj i ngushtë (prindërit, fëmija , vëllai, ose partneri jetësor) është vrarë.

2. Çfarë të drejta shtesë Ju takojnë Juve?

- Nëse Ju kërkoni informata ose kopje nga dosja, nuk është e domosdoshme të jepni arsye për këtë kërkesë.
- Nëse doni të dini, se personi i pandehur ose personi i dënuar është, apo a është akoma në arrest, nuk është e nevojshme për të arsyetuar një interes të ligjshëm për marrjen e të dhënave.
- Avokati Juaj ka të drejtë të jetë i pranishëm kur gjyqtari para fillimit të procedurës gjyqësore të merr në pyetje të pandehurin ose dëshmitarin.
- Me kërkesën e Juaj, Juve ju dërgohet aktakuza.
- Edhe për caktimin e terminëve të procedurës gjyqësore, me kërkesën e Juaj mund të informoheni.
- Ju dhe avokati Juaj mund të marrë pjesë gjatë gjithë procedurës gjyqësore.
- Ju mund të jeni në cilinë e bashkëpadisë. Si bashkëbaditës keni edhe këto të drejta shtesë të shënuar mëposhtme:
 - Ju automatikisht do të marrin aktakuzën.
 - Ju dhe avokati Juaj do të ftohen në procedurën kryesore gjyqësore.
 - Ju në seancës gjyqësore mund të bëni pyetje ose të parashtroni kërkesa.
 - Ju do të jeni i informuar në të njëjtën masë si prokurori publik sa i përket dëgjimeve dhe vendimeve të gjykatës.

Në procedurë penale kundër autorëve të moshës nën 18 vjeçare bashkëpadia mund të jetë prezent vetëm për disa krime serioze të caktuara.

3. Kush i mban shpenzimet e mija në këto raste?

Nëse i akuzuari dënohet, ai normalisht duhet të paguaj shpenzimet e bëra (për shembull avokatin), në qoftë se ai është në gjendje për ta bërë këtë. Përndryshe, Ju vet duhet ti mbani shpenzimet tuaja.

Në disa raste të rënda, gjykata duhet pa marrë parasysh gjendjen tuaj ekonomike më kërkesën tuaj të caktoj Juve një avokat që zakonisht ju këto shpenzime nuk do ti paguani.

Në raste të tjera, Juve me kërkesën e Juaj, duke marrë parasysh gjendjen tuaj financiare mund të vendoset, që shpenzimet e Juaja të paguhet nga kasa shtetërore dhe të caktohet një ndihmë juridike ose një avokat. Ju atëherë shpenzimet e avokatit nuk duhet ti paguani për aktivitetet e tij ose shtetit ju jep akontacion për shpenzimet

qe duhet të paguani, te cilat Juve i ktheni më vonë në këste te caktuara. Ndhimesë ligjore për pagimin e shpenzimeve merrni vetëm në atë rast, nëse Ju keni të ardhura të ulëta dhe vetëm atëherë nëse Ju interesin tuaj me ndihmën e një avokati mund ti prezantoni më mirë ose pjesëmarrja e Juaj procedura penale gjyqësore pa avokat nuk mund të kërkohet nga Ju.

E rëndësishme është se ju mund të kërkoni nga gjykata qe zgjedhja e Juaj e lirë e një avokati të respektohet, edhe nëse Juve ende nuk ju është miratuar kërkesa e pagimit te shpenzime procedurale gjyqësore.

III. Informata tjera sa i përket mbështetjes shtesë

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër, Ju lutem te kontaktoni zyrën e caktuar gjyqësore, ndonjë avokat, ose ndonjë organizatë qe merret me mbështetjen e viktimave.

Në rast të shkaktimit të qëllimshëm te lëndimeve trupore, dëme te shëndetin, apo të privimit nga liria ose në lidhje me këtë keni kërcënime, çrregullime te qetësisë shtëpiake, si dhe jeni i nënshtruar në ngacmime permanente të pa durueshme (stalking), ju mund të kërkoni të ndihmoheni në bazë të ligjit për mbrojtje nga dhuna pran gjykatës komunale në mënyrë për të mbrojtur kundër sulmeve të mëtejshme te mundshme. Nëse ju nuk keni autorizuar ndonjë avokat, ju mund të merrni më shumë informacion në zyrën gjykatës komunale se caktuar.

Sipas ligjit për kompensimin e viktimave për pasojat e shkaktuara me dhunë nga personat dhe atyre ju kanë shkaktuar dëme në shëndet, ose vuajnë familjaret e tyre, për shkak të dëmeve shëndetësore dhe pasojat ekonomike ata më kërkesë mund te përkujdesën dhe furnizohen. Përfitime në bazë të furnizimit dhe përkujdesjes mund të përfshijë edhe shpenzimet për përkujdesje psikologjike, një ndihmë në shtëpi ose një pension për kompensim të viktimës.

Për të sqaruar një kërkesë eventuale të tillë ju duhet të kontaktoni zyrën përgjegjëse për çështjet sociale dhe të kujdesit.